



KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 202, dt. 25.09.2015

Në mbështetje të nenit 28 dhe nenit 32 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 25.09.2015, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit për shpalljen monument kulture, kategoria e I-rë, “Piktogramet në strehën shkëmbore pranë Rubikut”, Mirditë.
2. Miratimin e propozimit të zonës së mbrojtur të monumenteve “Piktogramet në strehën shkëmbore pranë Rubikut” dhe “Kalaja e Rubikut”, Rubik, Mirditë.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI